



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr. 107/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ne përbërje të: z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE: “PBC” SH.P.K. – Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: “DataProgNet” Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Blerja e Softwerit për Menagjimin e Performancës dhe Softwerit për Arkiven Elektronike si dhe shërbime të digjitalizimit të Arkivës – Ri Tender” me nr. të prokurimit: numër “624-20-8304-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”, më datën: 10.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE: “PBC” SH.P.K. – Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Blerja e Softwerit për Menagjimin e Performancës dhe Softwerit për Arkiven Elektronike si dhe shërbime të digjitalizimit të Arkivës – Ri Tender” me nr. të prokurimit: numër “624-20-8304-1-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë” .

II. VËRTETOHET, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Blerja e Softwerit për Menagjimin e Performancës dhe Softwerit për Arkiven Elektronike si dhe shërbime të digjitalizimit të Arkivës – Ri Tender” me nr. të prokurimit: “624-20-8304-1-2-1”, iniciuar nga AK – KK Suharekë .

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të

Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik OE: "PBC" SH.P.K. – Prishtinë, aprovohet si pjesërisht e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik "PBC" SH.P.K. – Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 04.02.2021 me nr. 107/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Blerja e Softwerit për Menagjimin e Performancës dhe Softwerit për Arkiven Elektronike si dhe shërbime të digjitalizimit të Arkivës – Ri Tender" me nr. të prokurimit: numër "624-20-8304-1-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – "KK Suharekë", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7 parag 6, 56, 59 parag 4, dhe 69, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës .

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 12.02.2021, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt: 03.03.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Përgjigje në pretendimet ankimore te OE ankues : Sqarim hyrës: Fillimisht sqarojmë se pretendimi ankimor i parashtruar në këtë ankesë ka të bëjë tenderin e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë. OE ankues ka paraqitur kërkesën për rishqyrtim dhe ankesë në OSHP mbi pretendimet. Pas shqyrtimit në detaje të pretendimit të OE ankues, analizimit të DT, FPO, specifikacionit teknik, përshkrimi i çmimeve vendimeve të AK, kërkesave për sqarime dhe fakteve të kësaj ekspertize..

Pretendimet Ankimore të OE ankues, se OE i propozuar për kontratë nuk i plotëson këto:

Pretendimi 1: Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka përfunduar me sukses të paktën tri kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C# dhe furnizime me pajisje të TIK, atë si vijon Dy prej tyre brenda institucioneve të Republikës së Kosovës të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës

.NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#. Një prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework).

OE i rekomanduar për kontratë nga AK, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që i përmbush kërkesat e lartcekura, të përcaktuara në dosjen e tenderit

Përgjigje në Pretendimin 1: OE i rekomanduar për kontratë nga AK, ka dorëzuar në e-prokurim në ofertën e tij në rastin e aplikimit të gjitha kërkesat lidhur me kontratat dhe referencat. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Listën e projekteve të bashkangjitur me kontrata dhe referenca. Vlera e të cilave tejkalon si për nga numri ashtu edhe nga vlera kërkesat e AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. OE "DataProgNet" SHPK. I përmbush kërkesat dhe se ka përfunduar me sukses të paktën tri kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C# dhe furnizime me pajisje të TIK, atë si vijon

Dy prej tyre brenda institucioneve të Republikës së Kosovës të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#.

Një prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework). Pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërke në DT dhe NJK është **I PABAZUAR**.

Pretendimi 2: Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të dëshmoj se ka te punësuar me kontratë ose parakontratë ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve, si në vazhdim Një (1) Zyrtar e Menaxher i projektit. a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në drejtimit e lartcekura, b. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për menaxhim te teknologjisë informative ose të jetë i certifikuar për PMP ose Prince 2 pas diplomimit, c. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare, d. Deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit, nga ana e OE pjesëmarrës.

Nga dëshmitë e dorëzuara shifë qarte se OE i rekomanduar për kontratë ne lidhje me kerkesen Zyrtar – Menaxher i Projektit perkerkesen a) dhe b) nuk përmbushën, Menaxheri i projektit ka dorëzuar diplomë e cila nuk përkon me titullin dhe drejtimin e kërkuar, si dhe për kërkesën në pikën B, ka dorëzuar certifikatë e cila ka skaduar 9 ditë para dorëzimit të ofertës, pra me 12.12.2020

Përgjigje në Pretendimin 2: OE i rekomanduar për kontratë nga AK, ka dërrëzuar në e-prokurim në ofertën e tij në rastin e aplikimit Diplomën lidhur me menaxherin e projektit, vendimin e menaxherit të projektitt. Z Sabedin Meha ka të përfunduar drejtimin: Kompjuterike me telekomunikacion dhe merr titullin Inxhinier i

Diplomuar. Bashkangjitur Diplomes OE ka dorëzuar edhe shtojcën e diplomës ku njihet ekuivalentimi dhe baraspesha, Studimet Themelore Universitare Sistemi Para Bolonjes – 4.5 vite / 9 semestra. Ekuivalent me 300 ECTS Kredi – Bazuar ne kohezgjatjen e studimeve sipas Udhezimit Administrativ 11/2015. Dokument ky me nr. Prot: 6442/15 dt. 23.10.2015. Ndërsa lidhur me validitetin e Certifikatën PMP, sqarohet se ky certifikim është periodik megjithate ky Certifikim është i vlefshëm në rastin kur AK ka shpallur njoftimin për kontratë. Certifikata për PMP është certifikatë e cila është periodike me validitetin e ri deri më 12 December 2023. Pretendimi ankimor lidhur me mospërbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi 3:Një (1) Zyrtar e për Data Bazë a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli Bachelor në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike, b. Të ketë përfunduar certifikimin si Specialist për implementim dhe mirëmbajtje të bazave të të dhënave SQL nga Microsoft ose organizate ekuivalente, c. Të ketë përfunduar certifikimin si Specialist ne .Net, ASP.Net nga Microsoft ose organizate ekuivalente, d. Të ketë përvojë pune si ekspert për data baze minimum 3 projekte, e. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare.

OE pretendon se nga dëshmitë e dorëzuara shihet qartë që OE i rekomanduar për kontratë Zyrtarin e DataBazë, pika B) nuk e përmbush kërkesën minimale të DT pasi që, AK ka kërkuar ekspert të Data Bazë-ve të specializuar implementim dhe mirëmbajtje të bazave të të dhënave SQL e jo Zyrtar të certifikuar për Zhvillim të SQL. Certifikimi .Net ASP.Net e jo zyrtar për DataBazë.

Përgjigje në Pretendimin 3: Pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar të Bazës së të dhënave me kritere dhe kërkesa kontradiktore të cilat duhet të jetë i certifikuar edhe ne ASP.NET dhe në SQL. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listen e stafit dhe tek pozita për ekspert të Data Bazë ka vendosur z. Betim Krasniqi dhe znj. Gyltene Tafa

Z. Gyltene Tafa ka certifikime në Microsoft dhe SQL, ndërsa z. Betim Krasniqi ka certifikime SQL nga organizata relevante të cilat janë ekuivalente si ëschools. Këto janë certifikime të cilat vërtetojnë që pjesëmarrësit e zotërojnë këtë fushë. Pretendimi ankimor lidhur me mospërbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **I pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi 4:Një (1) Zyrtar e Arkitekt sistemi a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në drejtimet e lartcekura, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Arkitekt sistemi minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare. OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nga AK për zyrtarin e Arkitekt Sistemit nuk i përmbush kërkesat minimale.

Përgjigje në Pretendimin 4: Pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar ASP.NET MVC webApplication, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar z. Hysen Sadiku i cila ka të përfunduara 3 certifikime në Microsoft. Certifikimi i cili e përmbush kriterin nga AK është certifikimi Microsoft Certified Professional nga Microsoft Certified Professional për ASP.NET dhe webapplications. Programming in C#. Pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **I PABAZUAR**.

Pretendimi 5: Një (1) Zyrtar e Analisti i projektit a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në drejtimet e lartcekura, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Analisti i projektit minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare. OE ankues preten se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter lidhur me kërkesat në DT dhe NJK.

Përgjigje në Pretendimin 5: Pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar për Analist i projektit . OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listen e stafit dhe tek pozita për Analist te projektit ka vendosur z. Ylber Murseli dhe z. Avni Hajadri ka certifikime në Microsoft dhe SQL nga organizata relevante të cilat janë ekuivalente si ëschools. Këto janë certifikime të cilat vërtetojnë që pjesëmarrësit e zotërojnë këtë fushë. Pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **pjesërisht i bazuar**.

Pretendimi 6: Dy (2) Zyrtar e për Zhvillim Softueri a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli Bachelor në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Arkitekt sistemi minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare. OE ankues preten se OE i rekomadnuar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter lidhur me kërkesat në DT dhe NJK.

Përgjigje në Pretendimin 6: Pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me përmbushjen e kërkesave për Zhvillues të Softuerit sqarohet se z. Ridvan Berisha dhe z. Visar Berisha posedojnë kualifikime universitare të cilat janë kërkuar, përvojën e punës dhe kualifikimet dhe certifikimet. Pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **I PABAZUAR**.

Pretendimi 7: OE ankues pretend se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar sipas kërkesës në

njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe aneksin 1 të specifikimit të kërkesave lidhur me minimumin e specifikacionit teknik. Kërkesa për lexim të avancuar, Kërkesa për Destinim të brendshëm dhe njoftim automatik, Kërkesa për etikedë on the fly, Kërkesa për Skanimin e dokumenteve një nga një të cilat do të kenë mundësi të integritetit, në numër të pakufizuar.

Përgjigje në Pretendimin 7: Pas analizës dhe verifikimit të detajit të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me përmbushjen e kërkesave për minimumin e kërkesave në specifikacionin teknik, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklaratën e specifikacionit teknik, deklaratën për dorëzim të kodeve burimore, specifikacionin teknik për pajisje dhe softëra dhe i përmbush Kërkesa për lexim të avancuar, Kërkesa për Destinim të brendshëm dhe njoftim automatik, Kërkesa për etikedë on the fly, Kërkesa për Skanimin e dokumenteve një nga një të cilat do të kenë mundësi të integritetit, në numër të pakufizuar. OE Pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është **I PABAZUAR**.

OE i rekomanduar "DataProgNet" ka vlerë 44,245.00 Euro ndërsa OE ankues "PBC" SHPK, ka vlerën 63,928.75 Euro.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet dhe të gjeturat në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues teknik i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht të bazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për dhënie të kontratës.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 04.03.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **PAJTOHET** plotësisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 07.03.2021, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se **Nuk Pajtohet** me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 10.03.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverballi mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues,

konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues, se OE i propozuar për kontratë nuk i plotëson kriterin e dosjes së tenderit: Operatori ekonomik duhet të dëshmoj se ka përfunduar me sukses të paktën tri kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C# dhe furnizime me pajisje të TIK, atë si vijon: Dy prej tyre brenda institucioneve të Republikës së Kosovës të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#. Një prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework).

OE i rekomanduar për kontratë nga AK, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që i përmbush kërkesat e lartcekura, të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Paneli shqyrtues konform mendimit të ekspertit shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nga AK, ka dorëzuar në e-prokurim në ofertën e tij në rastin e aplikimit të gjitha kërkesat lidhur me kontratat dhe referencat. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar Listën e projekteve të bashkangjitur me kontrata dhe referenca. Vlera e të cilave tejkalon si për nga numri ashtu edhe nga vlera kërkesat e AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. OE "DataProgNet" SHPK. i përmbush kërkesat dhe se ka përfunduar me sukses të paktën tri kontrata të zhvilluara në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C# dhe furnizime me pajisje të TIK: Dy prej tyre brenda institucioneve të Republikës së Kosovës të implementuara dhe zhvilluara me sukses në teknologji të Microsoft përmes paketës .NET Framework, teknologjisë ASP.NET MVC, gjuhës programuese C#.

Një prej tyre për furnizim me pajisje të IT'së dhe avancim e mirëmbajtje të suksesshëm të softuerit te zhvilluar ne teknologji të Microsoft (Microsoft SQL Server dhe .NET Framework). Andaj duke u bazuar në sqarimin e dhënë si më lartë, paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është i paqëndrueshem.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së dosjes së tenderit se Operatori Ekonomik ose Grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të dëshmoj se ka te punësuar me kontratë ose parakontratë ekspertë të kualifikuar me përgatitje shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës dhe në veçanti të personave që drejtpërdrejt janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve, si në vazhdim

Një (1) Zyrtar e Menaxher i projektit a). Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në

drejtimet e lartcekura, b). Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për menaxhim të teknologjisë informative ose të jetë i certifikuar për PMP ose Prince 2 pas diplomimit, c). Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare, d). Deklaratë për caktimin e Menaxherit të Projektit, nga ana e OE pjesëmarrës.

Nga dëshmitë e dorëzuara shihet qartë se OE i rekomanduar për kontratë në lidhje me kërkesën Zyrtar – Menaxher i Projektit për kërkesën a) dhe b) nuk përmbushën, Menaxheri i projektit ka dorëzuar diplomë e cila nuk përkon me titullin dhe drejtimin e kërkuar, si dhe për kërkesën në pikën B, ka dorëzuar certifikatë e cila ka skaduar 9 ditë para dorëzimit të ofertës, pra me 12.12.2020

Paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për kontratë nga AK, ka dorëzuar në e-prokurim në ofertën e tij në rastin e aplikimit Diplomën lidhur me menaxherin e projektit, vendimin e menaxherit të projektit. Z Sabedin Meha që ka të përfunduar drejtimin: Kompjuterikë me telekomunikacion dhe merr titullin Inxhinier i Diplomuar. Bashkangjitur Diplomës OE ka dorëzuar edhe shtojcën e diplomës ku njihet ekuivalentimi dhe baraspesha, Studimet Themelore Universitare Sistemi Para Bilonjës – 4.5 vite / 9 semestra. Ekuivalent me 300 ECTS Kredi – Bazuar në kohëzgjatjen e studimeve sipas Udhëzimit Administrativ 11/2015. Dokument ky me nr. Prot: 6442/15 dt. 23.10.2015. Ndërsa lidhur me validitetin e Certifikatën PMP, sqarohet se ky certifikim është periodik megjithatë ky Certifikim është i vlefshëm në rastin kur AK ka shpallur njoftimin për kontratë. Certifikata për PMP është certifikatë e cila është periodike me validitetin e ri deri më 12 December 2023.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket OE të rekomanduar se nuk ka plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit: Një (1) Zyrtar e për Data Bazë a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli Bachelor në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike, b. Të ketë përfunduar certifikimin si Specialist për implementim dhe mirëmbajtje të bazave të të dhënave SQL nga Microsoft ose organizate ekuivalente, c. Të ketë përfunduar certifikimin si Specialist në .Net, ASP.Net nga Microsoft ose organizate ekuivalente, d. Të ketë përvojë pune si ekspert për data baze minimum 3 projekte, e. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare.

OE pretendon se nga dëshmitë e dorëzuara shihet qartë që OE i rekomanduar për kontratë Zyrtarin e DataBazës, pika B) nuk e përmbush kërkesën minimale të DT pasi që, AK ka kërkuar ekspert të Data Bazë-ve të specializuar implementim dhe mirëmbajtje të bazave të të dhënave SQL e jo Zyrtar të certifikuar për Zhvillim të SQL. Certifikimi .Net ASP.Net e jo zyrtar për DataBazë.

Paneli shqyrtues sqaron se pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar të Bazës së të dhënave me kritere dhe kërkesa kontradiktore të cilat duhet të jetë i certifikuar edhe në ASP.NET dhe në SQL. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listen e stafit dhe tek pozita për ekspert të Data Bazë ka vendosur z. Betim Krasniqi dhe znj. Gyltene Tafa

Z. Gyltene Tafa ka certifikime në Microsoft dhe SQL, ndërsa z. Betim Krasniqi ka certifikime SQL nga organizata relevante të cilat janë ekuivalente si w3schools. Këto janë certifikime të cilat vërtetojnë që pjesëmarrësit e zotërojnë këtë fushë, andaj edhe pretendimi ankimor është pjesërisht i qëndrueshem.

Në lidhje me pretendimin ankimor të OE ankues sa i përket OE të rekomanduar për kontratë sipas të cilit i njëjti nuk ka plotësuar kriterin e DT: Një (1) Zyrtar e Arkitekt sistemi a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në drejtimet e lartcekura, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Arkitekt sistemi minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare, ku OE ankues pretendon që OE i rekomanduar për kontratë nga AK për zyrtarin e Arkitekt Sistemit nuk i përmbush kërkesat minimale.

Paneli shqyrtues sqaron se pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar ASP.NET MVC webApplication, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar z. Hysen Sadiku i cila ka të përfunduara 3 certifikime në Microsoft. Certifikimi i cili e përmbush kriterin nga AK është certifikimi Microsoft Certified Professional nga Microsoft Certified Professional për ASP.NET dhe webapliactions. Programming in C#. Andaj, nga sqarimet e dhëna si më lartë paneli shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor lidhur me mospërmbushjen e kësaj kërkesë në DT dhe NJK është i pabazuar.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kriterit të dosjes së tenderit: Një (1) Zyrtar e Analisti i projektit a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli master për Inxhinieri Informatike ose Kompjuterike (shkenca kompjuterike ose inxhinieri softuerike) apo Inxhinier i Diplomuar në drejtimet e lartcekura, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Analisti i projektit minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare, ku OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter lidhur me kërkesat në DT dhe NJK.

Paneli shqyrtues sqaron se pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë. Shifet se AK ka kërkuar 1 zyrtar për Analist i projektit. OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listen e stafit dhe tek pozita për Analist te projektit ka vendosur z. Ylber Murseli dhe z. Avni Hajadri ka certifikime në Microsoft dhe SQL nga organizata relevante të cilat janë ekuivalente si 3schools. Këto janë certifikime të cilat vërtetojnë që pjesëmarrësit e zotërojnë këtë fushë, andaj pretendimi ankimor në këtë fushë është i pjesërisht i qëndrueshem.

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkesës së doosjes së tenderit: Dy (2) Zyrtar e për Zhvillim Softueri a. Të ketë përfunduar studimet minimum niveli Bachelor në shkenca kompjuterike, ose inxhinieri softuerike, ose inxhinieri kompjuterike, b. Të ketë përfunduar certifikimin për ASP.NET MVC webApplications, c. Të ketë përvojë pune si Arkitekt sistemi minimum 3 projekte, d. Të ketë përvojë minimum pesë (5) vjeçare, ku OE ankues pretendon se OE i rekomadnuar për kontratë nuk e plotëson këtë kriter lidhur me kërkesat në DT dhe NJK.

Paneli shqyrtues pas analizës dhe verifikimit detal të kërkesave në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me përmbushjen e kërkesave për Zhvillues të Softuerit vlerëson se z. Ridvan Berisha dhe z. Visar Berisha posedojnë kualifikime universitare të cilat janë kërkuar, përvojën e punës dhe kualifikimet dhe certifikimet, andaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar sipas kërkesës në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe aneksin 1 të specifikimit kërkesat lidhur me minimumin e specifikacionit teknik. Kërkesa për lexim të avancuar, Kërkesa për Destinim të brendshëm dhe njoftim automatik, Kërkesa për etiketë on the fly, Kërkesa për Skanimin e dokumenteve një nga një të cilat do ta kenë mundësinë e integritetit, në numër të pakufizuar. Paneli shqyrtues sqaron se pas analizës të dokumentacioneve të dorëzuara nga OE i rekomanduar për kontratë lidhur me përmbushjen e kërkesave për minimumin e kërkesave në specifikacion teknik, shihet se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar deklaratën e specifikacionit teknik, deklaratën për dorëzim të kodeve burimore, specifikacionin teknik për pajisje dhe softëer dhe i përmbush Kërkesa për lexim të avancuar, Kërkesa për Destinim të brendshëm dhe njoftim automatik, Kërkesa për etiketë on the fly, Kërkesa për Skanimin e dokumenteve një nga një të cilat do ta kenë mundësinë e integritetit, në numër të pakufizuar. andaj pretendimi ankimor është i paqëndrueshëm.

Me tej paneli shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar "DataProgNet" ka ofertuar me çmim prej 44,245.00 Euro ndërsa OE ankues "PBC" SHPK, ka çmimin 63,928.75 Euro.

Paneli shqyrtues pas vlerësimit të procedurës së prokurimit shkresave të lëndës dhe fakteve të prezantuara, duke u mbështetur në mendimin e ekspertit shqyrtues teknik, vlerëson se AK ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së kur ka zhvilluar këtë procedurë të prokurimit si dhe ka respektuar nenin 60 të LPP-së kriteret e dhënies së kontratës, sepse ka rekomanduar operatorin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK-në gjatë zhvillimit të procedurës të prokurimit ka vepruar në harmoni me dispozitat e LPP-së si dhe ka pasur parasysh nenin 1 të këtij ligji kur dihet se qëllimi i ligjit për prokurim publik

është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- "KK Suharekë"

1x1 OE - "PBC SHPK Prishtinë"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.